

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI HUAMARRËS, BANKËS SË SHQIPËRISË, SI AGJENT I HUAMARRËSIT, DHE BASHKIMIT EVROPIAN, TË PËRFAQËSUAR NGA KOMISIONI EVROPIAN, SI HUADHËNËS, PËR “LEHTËSINË E REFORMËS DHE ZGJERIMIT PËR BALLKANIN PERËNDIMOR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për “Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”, që do të mundësojë financimin e programit të sipërpërmendur, nëpërmjet akordimit të një huaje në vlerën 657 458 743.67 euro, i shoqëruar nga një grant WBIF, në shumën 264 6271 44.33 euro.

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është çlirimi i potencialit ekonomik të vendit, përmes stimulimit të transformimit ekonomik dhe përmirësimit të klimës së biznesit për të hyrë gradualisht dhe i përgatitur në tregun e vetëm të BE-së, përmes forcimit të shtetit të së drejtës, me progres të vazhdueshëm në integrimin e përshpejtuar, konsolidimin e efikasitetin e reformave, dhe ecjes së qëndrueshme përpara në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, i cili, në pjesën për integrimin evropian përcakton se “Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian është një objektiv kombëtar, në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare, në përputhje me vlerat dhe parimet e Evropës së Bashkuar.”

Projektvendimi i hartuar nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve dhe Planin Kombëtar të Integritimit Evropian për vitin

2024, pasi vjen në vazhden e zhvillimeve pozitive nga Bashkimi Evropian, (Rregullorja 2024/1449, e cila u miratua në maj të vitit 2024) të cilat nuk ishin të miratuara në kohën e hartimit/miratimit të PPAP-së dhe PKIE-së 2024.

Integrimi evropian është synimi politik dhe strategjik më i rëndësishëm i Republikës së Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Vizioni dhe objektivat strategjike kombëtare për integrimin evropian përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE) 2022-2030, ku qëllimi parësor i politikës kombëtare është integrimi evropian i vendit.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Komisioni Evropian, më 8 nëntor 2023, në kuadër të paketës së zgjerimit 2023, lançoi nismën për propozimin e planit të ri të rritjes për Ballkanin Perëndimor, pjesë e të cilit është dhe mbështetja përmes instrumentit “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.

Kjo iniciativë e re zhvillimore do të ofrojë mundësinë për mbështetje financiare, deri në 6 miliardë euro për periudhën 2024-2027, për të gjashta vendet e Ballkanit Perëndimor si mbështetje nëpërmjet katër shtyllave të tij:

1. Integrim në tregun e vetëm të Bashkimit Evropian;
2. Integrim rajonal;
3. Integrim i përsheptuar përmes reformave kombëtare të rritjes;
4. Instrumenti financiar për reforma dhe rritje në Ballkanin Perëndimor.

Ky instrument është miratuar më 14 maj 2024, përmes rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian “Për miratimin e facilitetit të reformave dhe rritjes për Ballkanin Perëndimor”.

Si parakusht për vendin për të aktivizuar mundësinë për të përfituar nga fondet e facilitetit të reformave dhe rritjes 2024-2027 për Ballkanin Perëndimor është hartimi dhe miratimi i dokumentit të politikës “Agjendës Kombëtare e Reformave 2024-2027”, (miratuar me vendimin nr.621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave) në kontekstin e planit të rritjes për Ballkanin Perëndimor të Bashkimit Evropian. AKR 2024-2027 përcakton reformat që duhet të ndërmerren nga përfituesi si dhe zonat e investimit, të cilat duhet të ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse për arritjen e objektivave të lehtësisë në bazë të një marrëveshjeje lehtësie dhe një marrëveshjeje huaje që do të lidhen ndërmjet Bashkimit Evropian dhe huamarrësit.

Prioritetet e reformave të përcaktuara në AKR 2024-2027 janë në përputhje me drejtimet prioritare që përcakton plani i ri i rritjes për Ballkanin Perëndimor, me qëllim përsheptimin e integritit të ekonomisë shqiptare në tregun e vetëm të Bashkimit Evropian, përsheptimin e rritjes e të konvergencës dhe përsheptimin e integritit të vendit në Bashkimin Evropian, si dhe thellimin e integritit ekonomik rajonal, me objektiv kryesor mbështetjen për dyfishimin e rritjes ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, deri në vitin 2030.

Objektivat kryesorë të këtij programi janë të shumëfishtë, duke përfshirë aspekte të ndryshme të qeverisjes, zhvillimit ekonomik dhe progresit shoqëror, si më poshtë vijon:

### **Objektivi 1: Rritja e konkurrueshmërisë dhe qeverisjes ekonomike**

Objektivi i parë është konsolidimi i reformave që mundësojnë e mbështesin transformimin e mëtejshëm të Shqipërisë në një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, e drejtuar nga qeverisja ekonomike transparente, infrastruktura ekonomike efikase dhe një kuadër ligjor i favorshëm për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e eksporteve, që përputhet me *acquis* dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

### **Objektivi 2: Zhvillimi i qëndrueshëm i kapitalit njerëzor - reformimi më tej i arsimit, për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të përgatitur nga përkëpamja digjitale**

Objektivi i dytë fokusohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke krijuar një sistem arsimor dinamik që pajis studentët dhe punonjësit me aftësitë përkatëse dhe kompetencën digjitale të nevojshme në ekonominë globale, duke nxitur inovacionin dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare, zhvillimin e produktivitetit dhe fuqisë punëtore të kualifikuar. Në kuadër të këtij objektivi, përvijohen iniciativa të ndryshme të parashikuara si masa për rritjen e efektivitetit të sistemit arsimor profesional, përafrimin e tij me kërkesat në përgjigje të zhvillimeve dinamike të tregut të punës dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në tregun e punës, si dhe më gjerë, me zhvillimin e ekonomisë.

### **Objektivi 3: Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme**

Objektivi i tretë përqendrohet në transformimin digjital, duke krijuar një shoqëri digjitale udhëheqëse të zhvillimit dhe rritjes, ku infrastrukturat digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe efikase mbështesin shërbimet publike dhe transformimin ekonomik e sigurojnë qëndrueshmëri kibernetike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

#### **Objektivi 4: Konsolidimi i qëndrueshmërisë energjetike dhe integrimi i tregut shqiptar në atë të BE-së**

Objektivi i katërt fokusohet në energjinë dhe tranzicionin e gjelbër, me synimin për të transformuar Shqipërinë në një lider rajonal të energjisë, nëpërmjet adoptimit të standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian, duke nxitur një treg konkurrues dhe transparent të energjisë, duke adresuar risqet nga varfëria energjetike dhe aspektet mjedisore, si dhe duke rritur përpjekjet e mëtejshme në tranzicionin e gjelbërt.

#### **Objektivi 5: Konsolidimi i shtetit të së drejtës**

Objektivi i pestë synon të kontribuojë në garantimin e paktyeshmërisë së reformës në drejtësi dhe të konsolidojë më tej punën për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, nëpërmjet masave që luftojnë krimin e organizuar, parandalojnë dhe ulin incidencën e korrupsionit, rrisin efikasitetin e gjyqësorit dhe promovojnë transparencën dhe lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane.

Ky projektligj propozohet të miratohet me procedurë të përshpejtuar për shkak të rëndësisë që paraqet në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si një prioritet kryesor i qeverisë shqiptare. Përshpejtimi i procedurave të miratimit është i nevojshëm për të mbështetur dinamizmin e reformave të kërkuara nga Bashkimi Evropian, të cilat janë pjesë e kushteve të integritit, si dhe për të siguruar mbështetje financiare për realizimin e këtyre reformave.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është propozuar në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83, pika 2 dhe 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Marrëveshja e huas është miratuar në parim me vendimin nr.65, datë 29.1.2025, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar midis palëve. Në zbatim të nenit 121, pika 1, shkronja “ç” të Kushtetutës, ajo do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk përafrohet në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por vë në zbatim për Shqipërinë rregulloren 2024/1449 të Bashkimit Evropian.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji propozon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për “Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Financave.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Në realizimin e programit janë përfshirë disa ministri dhe institucione të ndryshme, duke siguruar një bashkëpunim ndërinstitucional të ngushtë për të garantuar efektivitetin dhe përmbushjen e kërkesave të Bashkimit Evropian në procesin e integritetit të Shqipërisë.

Projektligji i propozuar është hartuar nga struktura përkatëse pranë Ministrisë së Financave.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Marrëveshja e huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për “Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”, në këtë fazë nuk ka implikime buxhetore.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**